



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë më _____.____.2023

VENDIM

Nr. 639, datë 26.10.2023

PËR

**MBARIMIN E STATUSIT TË MAGJISTRATIT
PËR GJYQTAREN ZNJ. {...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 61 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar dhe në pikën 3, të nenit 65, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pas shqyrtimit të kërkesës për heqjen dorë nga statusi i magjistratit, me propozim të relatorit z. Klodian Kurushi,

VENDOSI :

1. Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për znj. {...}, për shkak të dorëheqjes së saj.
2. Efektet e këtij vendimi fillojnë më datë 30.11.2023.
3. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtarës znj. {...} sipas kërkesave të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR